



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES  
DREJTORIA E MBIKËQYRJES

Nr. 500 Prot.

Tiranë, më 07.062026

**URDHËR I BRENDSHËM**

Nr. 67, datë 07.062026

**PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES ME OBJEKT VERIFIKIMIN E ZBATIMIT  
TË LIGJSHMËRISË NË APLIKIMIN E INSTITUTIT TË PËRFUNDIMIT TË  
MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL PËR SHKAK TË LIGJIT, NË  
INSTITUCIONET E VARËSISË TË MINISTRISË SË MBROJTJES, PËR VITIN  
2025**

Në zbatim të nenit 11, pika 1, dhe nenit 14 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ligjit nr . 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, dhe Rregullores “Për procedurat e Mbikëqyrjes/Inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.3.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, të ndryshuar si dhe Vendimit nr. 82, dt. 31.12.2025, “Për miratimin e planit vjetor të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2026” ,

**URDHËROJ :**

1. Fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me institutin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, parashikuar nga neni 65 i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi, në institucionet e varësisë të Ministrisë së Mbrojtjes që janë pjesë e shërbimit civil gjatë vitit 2025.

Institucionet që do të përfshihen në këtë proces janë:

- a) Institucionet e varësisë të Ministrisë së Mbrojtjes.
  - Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit;
  - Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;

- b) Departamenti Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse.
2. Grupi i punës do të përbëhet nga Drejtori i Mbikëqyrjes, Altin Shumeli si dhe inspektorët Granit Bajri dhe Uajd Çorbaxhi.
  3. Grupi i punës do të jetë përgjegjës për verifikimin e të dhënave të administruara dhe analizën e procedurave të ndjekura nga njësia e burimeve njerëzore dhe njësia përgjegjëse (DAP), në përputhje me përcaktimet e nenit 65, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përkatësisht :
    - Përfundimi i marrëdhënies për shkak të ligjit kur: a) nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij; b) nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar; c) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë; ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit; d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
    - Do të verifikohen dhe administrohen të gjitha aktet administrative të cilat e konstatojnë ndodhjen apo njohjen e shkakut të përfundimit si akti që finalizon procesin nga: a) njësia e burimeve njerëzore e institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën; b) DAP-i, për anëtarët e TND-së.
  4. Mbikëqyrja për administrimin e dokumentacionit në subjekt do të fillojë sipas përcaktimeve në programin e punës dhe do të përfundojë në datë **22.04.2026**. Nëse gjatë fazës së përpunimit të të dhënave lind nevoja për të përsëritur vizitën në subjekt, ky proces do të realizohet me kërkesën e grupit të punës.
  5. Me përfundimin e këqyrjes së akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave, inspektori përkatës, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, do të vijojë procesin me përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e projektraportit të mbikëqyrjes. Projektraporti do t'i dërgohet institucionit të mbikëqyrur për t'u njohur me gjetjet, duke i lënë 5 ditë kohë për të përgatitur observacionet.
  6. Pas përfundimit të afatit për njohjen e subjektit të mbikëqyrur me raportin paraprak, grupi i punës do të hartojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ku do të përfshihet edhe analiza e observacioneve. Në datën **18.05.2026**, do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur.
  7. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet

mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij urdhri.

8. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të njoftojë grupin e punës për këtë akt dhe të sigurojë mbështetjen e grupit të punës me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Lefterije Elezhi (Luzi)**

